



Në bazë të neneve 57 dhe 59 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr.03/L-038 për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.26/2008), nenit 5 paragrafi 5.6 të Ligjit nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-020 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.29/2011), nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës, në mbledhjen e pestë të rregullt, e mbajtur më datën 07.06.2024, merr këtë:

**VENDIM NR.25/2024/KG
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KËRKESËN PËR VENDOSJEN E SIMBOLIT TË
KOMUNITETIT SERB – FLAMURIT KOMBËTAR, ME RASTIN E SHËNIMIT TË
FESTËS SË 28 QERSHORIT "VIDOVDAN"**

Neni 1

Jepet pëlqimi për kërkesën nr. 2552/24 të datës 29.05.2024, të paraqitur nga koalicioni i shoqërisë civile, për vendosjen e simbolit të komunitetit serb – flamurit kombëtar, me rastin e festës së 28 qershorit 2024 – "Vidovdan".

Neni 2

Simbolet e komunitetit serb - flamujt kombëtarë - mund të vendosen në hapësirat publike në territorin e Komunës së Graçanicës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Misha Dimitrijević

